

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME PËR MARRJEN, TRAJTIMIN E MOSTRAVE DHE KRYERJEN E EKSPERTIZAVE, SI DHE METODOLOGJINË E LLOGARITJES SË SHPENZIMEVE NË KËTO PROCEDURA”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim krijimin e kuadrit rregullator të detajuar për procedurat e marrjes dhe trajtimit të mostrave gjatë procesit të inspektimit, si dhe për kryerjen e ekspertizave të nevojshme laboratorike, në përputhje me standardet ligjore dhe teknike në fuqi. Projektvendimi përcakton gjithashtu metodologjinë për llogaritjen e shpenzimeve që lidhen me këto procedura, si dhe rregullat për ruajtjen, identifikimin dhe administrimin e mostrave për qëllime të verifikimit teknik, ankimimi administrativ dhe procesesh gjyqësore.

Përmes këtij akti synohet:

- Vendosja e rregullave të hollësishme për mënyrën e marrjes dhe trajtimit të mostrave në procesin inspektues, për të garantuar integritetin dhe objektivitetin e analizave;
- Përcaktimi i standardeve për ruajtjen, etiketimin dhe dokumentimin e mostrave, si dhe ndarjen e tyre për analiza të para, ankimore dhe gjyqësore;
- Rregullimi i procedurës së analizës laboratorike në përputhje me kërkesat për transparencë dhe akreditim profesional;
- Miratimi i metodologjisë për llogaritjen e shpenzimeve që lidhen me përzgjedhjen, transportin, analizimin dhe trajtimin e mostrave;
- Rritja e sigurisë juridike dhe mbrojtjes së të drejtave të subjekteve përmes përshkrimit të qartë të së drejtës për ankimim dhe procedurës për përsëritjen e analizave në raste kontestimi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për miratimin e procedurave të hollësishme për marrjen, trajtimin e mostrave dhe kryerjen e ekspertizave, si dhe metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve në këto procedura” është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2025, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave. Projektvendimi është hartuar në zbatim të përcaktimeve në ligjin nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për marrjen, trajtimin e mostrave dhe kryerjen e ekspertizave, si dhe miratimin e metodologjisë së llogaritjes së shpenzimeve në këto procedura” është një instrument thelbësor për zbatimin efektiv të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duke standardizuar dhe unifikuar praktikën ndërinstitucionale në trajtimin teknik dhe procedural të mostrave gjatë inspektimeve.

Krijimi i një kuadri të detajuar procedural ka ardhur si nevojë për të adresuar problematikat të përsëritura në praktikë, përfshirë:

- mungesën e standardeve të unifikuara për marrjen dhe ruajtjen e mostrave;
- paqartësitë në ndarjen dhe administrimin e mostrave për analizë, ankime dhe ekspertizë gjyqësore;
- mungesën e rregullave të qarta për mbulimin dhe transferimin e kostove të analizave;
- vështirësi në ruajtjen e gjurmueshmërisë dhe integritetit të mostrave gjatë gjithë zinxhirit të inspektimit dhe verifikimit.

Përparësitë kryesore të këtij projektvendimi përfshijnë:

- Standardizimin e praktikës për marrjen dhe trajtimin e mostrave, duke garantuar integritetin, ruajtjen dhe neutralitetin e analizave të kryera;
- Ndarjen e qartë të mostrave në funksion të analizës fillestare, ankimimit administrativ dhe procedurave gjyqësore, duke siguruar transparencë dhe të drejtë mbrojtjeje për subjektin;
- Miratimin e një metodologjie të unifikuar për llogaritjen e shpenzimeve, duke përcaktuar rastet kur ato përballohen nga inspektorati apo subjekti, në varësi të rezultatit të analizës;
- Përdorimin e sistemit elektronik “e-Inspektimi” për dokumentimin, gjurmimin dhe administrimin e gjithë procesit të marrjes, analizimit dhe vlerësimit të riskut mbi bazën e mostrave të marra.

Efektet e pritshme nga zbatimi i këtij akti përfshijnë:

- Rritjen e besueshmërisë dhe profesionalizmit të procedurave të inspektimit në raport me subjektet e inspektimit;
- Forcimin e pozicionit ligjor të trupës inspektuese përballë subjekteve, përmes një dokumentimi të saktë dhe të verifikueshëm të çdo etape të trajtimit të mostrës;
- Reduktimin e kontestimeve dhe mosmarrëveshjeve gjyqësore, për shkak të transparencës dhe rregullave të qarta procedurale;
- Sigurimin e një standardi të unifikuar për të gjithë inspektoratet qendrore dhe vendore në trajtimin e mostrave dhe kostove të lidhura me to;
- Krijimin e një baze të dhënash të qëndrueshme për analiza risku, vlerësim cilësie dhe përmirësim të politikave inspektuese në të ardhmen.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar mbështetet në nenin 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në nenin 23 pika 3, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, ky projektakt nuk përbën një akt nënligjor që sjell përfitime shtesë për subjektet e përfshira dhe, për pasojë, nuk bie ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vlerësim mbështetet në sqarimet e dhëna në shkresën zyrtare të KQZ-së, nr. prot., 1546, datë 03.03.2025, mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i ndarë në **3 krerë dhe 10 nene**, të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar procedurat për marrjen, trajtimin dhe analizimin e mostrave gjatë inspektimeve, si dhe metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të lidhura me këto procese:

Kreu I – Dispozita të përgjithshme (Nenet 1–3)

- **Neni 1:** Përcakton qëllimin e aktit, që konsiston në marrjen, trajtimin dhe analizimin e mostrave si pjesë e procedurave të inspektimit.
- **Neni 2:** Përcakton fushën e zbatimit për të gjitha inspektoratet qendrore, vendore dhe strukturat e tjera inspektuese.
- **Neni 3:** Jep përkufizimet kryesore si “mostër”, “etiketë”, “kod identifikimi”.

Kreu II – Rregulla të përgjithshme (Nenet 4–7)

- **Neni 4:** Rregullon procedurën për marrjen e mostrave gjatë inspektimit, numrin minimal të mostrave (jo më pak se pesë), ndarjen e tyre sipas qëllimit (analizë fillestare, ankim administrativ, dhe përdorim gjyqësor), mënyrën e etiketimit dhe dokumentimit përmes sistemit “e-Inspektimi”.
- **Neni 5:** Përcakton mënyrën e trajtimit të mostrave, rastet kur mostra merret jashtë programit vjetor, dhe rregullat për rastet kur ka dyshime të arsyeshme për tjetërsim të produkteve.
- **Neni 6:** Përshkruan metodologjinë e marrjes dhe dorëzimit të mostrave, pajisjet e përdorura, ruajtjen e sigurisë dhe etikës së procedurës, si dhe ndarjen e saktë të mostrave dhe plumbosjen në prani të subjektit të inspektimit.
- **Neni 7:** Sanksionon dokumentacionin shoqërues për çdo mostër, përfshirë autorizimin, formularët përkatës, faturat, certifikatat dhe raportet laboratorike.

Kreu III – Procedura për kryerjen e analizës laboratorike dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve (Nenet 8–9)

- **Neni 8:** Rregullon aspektet teknike të analizave laboratorike, përfshirë kërkesat për laboratorët, regjistrimin elektronik të rezultateve, formatin e fletë-analizës dhe procedurën e vlerësimit të riskut për produktet e inspektuara.
- **Neni 9:** Përcakton metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve, ndarjen e tyre ndërmjet inspektoratit dhe subjektit, në varësi të rezultatit të analizës dhe kushteve të kërkesës. Specifikohen zërat përbërës të kostos, si materiali, transporti, tarifat dhe afatet e pagesës.
- **Neni 10:** Rregullon të drejtën për ankim ndaj rezultateve të analizës, afatet për dorëzimin e ankimit, mundësinë për kryerjen e analizave të dyta dhe të treta, si dhe të drejtën për ndjekje të mëtejshme në gjykatë, përfshirë edhe ankimimin e kostove të analizës.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij projektvendimi janë ministritë e linjës, Inspektorati Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, vendore dhe laboratorët e përcaktuar në këtë projektvendim.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Inspektorati Qendror (në proces ristrukturimi si Inspektorati i Përgjithshëm), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, si dhe është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Drejtësisë, në zbatim të Urdhrit Nr. 49 datë 26.03.2025, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstitucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstitucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projekteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve "e-Inspektimi".

Projektakti do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Për zbatimin e këtij projektvendimi efektet buxhetore përballohen nga inspektoratet brenda buxhetit të parashikuar për vitin 2025, për këto institucione.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT

DELINA IBRAHIMAJ

